



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 18132 prot.

Vlorë, më ____ .09.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 2

DATË 25.08.2026 ORA 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2027 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.16533 prot, datë 13.08.2026.

Marrin pjesë:

Kryetare e Bashkisë Vlorë- znj. Brunilda Mersini, Nënkryetarja e Bashkisë – znj.Klea Lalo, Kryetari i Rajonit - z.Besi Gjondeda, Drejtor i Financës – z. Hqmet Haxhaj, anëtar të këshillit bashkiak, drejtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 36 persona)

Takimin e hap Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Dëgjesat publike nuk janë vetëm një detyrim ligjor, por mbi të gjitha janë pjesë e detyrës sonë për të dëgjuar qytetarët dhe për të orientuar investimet drejt nevojave reale të qytetit.

Një nga zonat që kërkon vëmendje dhe ndërhyrje është blloku i lagjes “Isa Boletini”, ku ka një numër të konsiderueshëm pallatesh të ndërtuara prej vitesh, shumë prej të cilave paraqiten të dëmtuara dhe kanë nevojë për restaurimin e fasadave dhe përmirësimin e hapësirave përreth.

Gjithashtu, në këtë zonë evidentohen ndërtime pa leje dhe problematika të tjera që ndikojnë në cilësinë e jetesës së banorëve. Për këtë arsye, kërkojmë bashkëpunimin tuaj për të ndërhyrë në mënyrë të organizuar, duke filluar me krijimin, sistemimin dhe rikualifikimin e hapësirave publike. Një tjetër investim i rëndësishëm është Shkolla “Ismail Qemali”, e cila

përbën një ndërhyrje me rëndësi për komunitetin dhe veçanërisht për fëmijët dhe familjet e kësaj zone.

Qëllimi ynë është që këto investime të mos jenë thjesht ndërhyrje infrastrukturore, por të sjellin një përmirësim të qëndrueshëm të cilësisë së jetës dhe të standardeve urbane në qytet. Kemi vendosur një kënd lojërash dhe kemi menduar gjithashtu për krijimin e tregjeve të lëvizshme, si dhe të një qendre për moshën e tretë. Synimi ynë është që investimi të jetë i integruar dhe t'u shërbejë të gjitha grupmoshave.

Sa i përket projektit për autobusët elektrikë, bëhet fjalë për një projekt që do të kërkojë kohën e nevojshme për t'u realizuar dhe që është në vëmendjen e Kryeministrit.

Përsa i përket rrugës “Donika Kastrioti”, po punojmë për hapjen e segmenteve të reja të rrugës, me qëllim lehtësimin e qarkullimit dhe përmirësimin e lëvizjes në qytet.

Në lidhje me ujësjellësin, aktualisht nuk kemi vendimmarrje në kompetencën tonë. Ndërkohë, pallatet në zonën e Lungomares ka ndërhyrje në tubacionet e ujësjellësit.

Jemi të hapur për t'ju dëgjuar.



Banor: Përshëndetje! Pallati përballë Shkollës “Ismail Qemali”, me nr.516, ka nevojë për restaurim.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Përshëndetje! Restaurimi i pallateve të vjetra është pjesë e planifikimeve tona. Kur të hartohet projekti, do të merrni informacionin përkatës. Objektivi është restaurimi i të gjithë pallateve të vjetra.

Banor: Përshëndetje. Problemi kryesor është kanali i ujërave të zeza, i cili ka nevojë për pastrim dhe mirëmbajtje.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Pengesat për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve vijnë si pasojë e banesave të ndërtuara në atë zonë, të cilat vështirësojnë aksesin dhe ndërhyrjen për pastrimin e kanalit.

Banor: Problem paraqesim ujërat e bardha që vijnë nga spitali, të cilat përhapen në rrugë dhe vështirësojnë kalimin. Gjithashtu, kërkohet pastrimi i kanalit të ujërave të Siavit, pasi bllokimi i tij shkakton përmbytje.

Banor: Problem paraqesim ndërtimet pa leje, për të cilat kërkohet marrja e masave përkatëse dhe prishja e tyre. Gjithashtu, pompat dhe bojlerët e pallateve shkaktojnë lagështi në banesa. Kërkohet ndërhyrja për verifikimin dhe sistemimin e problemit. Tubacionet janë të bllokuara dhe kërkohet pastrimi dhe mirëmbajtja e tyre.

Banor: Shpreh konsideratë për ju, Kryetare. Banoj në lagjen “Isa Boletini”. Pallati nr. 1356 ka nevojë për rikonstruktion, si dhe për bërjen e lulishtes.

Banor: Rruga “Rushit Gorishova” ka nevojë për zgjerim.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Fasadat e pallateve kanë nevojë urgjente për ndërhyrje në të gjithë qytetin.

Faleminderit!

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik